

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje nga gjyqtari i vetëm gjykues Sadije Selmani, me bashkëpunëtorin profesional, Shahadin Destani, në lëndën penale kundër të akuzuarve E S dhe F M për shkak se kanë kryer veprën penale, kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 parag. 1, të KP-së, sipas aktakuzës së PTH-së në Prizren, PP.II.nr.2985-5/17 të datës 27.11.2017, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë së Shtetit Musli Gashi, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre av.L S dhe av.O R, me datë 05.12.2017 merr këtë:

AKT GJYKIM

Të akuzuarit:

1. E S, nga i ati E, e ëma L, e lindur S, i lindur më , në K, tani me banim në T, rr. " , p.n., Republika e Shqipërisë, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i pamartuar, gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Shqipërisë, ka qenë në paraburgim me Aktvendim të Gjykatës Themelore në Prizren Ppr.nr.528/2017, të datës 12.11.2017, prej datës 11.11.2017 deri më datë 05.12.2017.

2. F M, nga i ati L, e ëma Z, e lindur K, i lindur më , në T, tani me banim në T, rr. " , p.n., ka të kryer shkollën fillore, mekanik-punëtor, i pamartuar, gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. të Shqipërisë, ka qenë në paraburgim me Aktvendim të Gjykatës Themelore në Prizren Ppr.nr.528/2017, të datës 12.11.2017, prej datës 11.11.2017 deri më datë 05.12.2017.

JANË FAJTORË

I. E S

Se me datë 10.11.2017, rreth orës 20:40 minuta, në pikën kufitare në fshatin V Komuna e Prizrenit, jashtë vend kalimit kufitar rreth bregut të liqenit të V, i akuzuari ka kaluar vijën kufitare të cilën patrulla e Stacionit Policor për mbikëqyrjen e kufirit në V, ka hasur në të akuzuarin duke lëvizur në këmbë, nga pjesa e liqenit i cili nuk kishte ujë, në drejtim të rrugës për në fshatin V; ku i akuzuari kishte kaluar vijën kufitare Sh - K, pa u lajmëruar në asnjërën pikë të kalimit kufitar, ku pas kontrollit i akuzuari nuk posedon kurrfarë dokumenti identifikues, ndërsa identifikimi i tij është bërë përmes Zyrës ndërlidhëse SPK në V;

Me këto veprime kryen veprën penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 parag. 1, të KP-së.

II. F. M

Se me datë, kohë të njëjtë si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i akuzuari kishte kaluar vijën kufitare Shqipëri – Kosovë, pa u lajmëruar në asnjërën pikë të kalimit kufitar, ku pas kontrollit i akuzuari nuk posedon kurrfarë dokumenti identifikues, ndërsa identifikimi i tij është bërë përmes Zyrës ndërlidhëse SPK në Vërmicë.

Me këto veprime kryen veprën penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 parag. 1, të KP-së.

Gjykata, në kuptim të dispozitave të nenit 4, 41, 43, 46, 50, 51, 73, dhe nenit 188 par. 1 nënpar. 1 lidhur me nenin 31 të KP-së, lidhur me nenin 365 të KPP-së, të akuzuarit Edison Sula dhe Fatmir Murataj i,

GJYKON

Me dënim me gjobë për secilin në shumën prej nga 500 (pesëqind) euro, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 11.11.2017 deri më datë 05.12.2017.

Të akuzuarit E S dhe F M lirohen nga obligimi që t' i paguajnë shpenzimet e procedurës penale ngase pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen e tyre materiale dhe të personave që ata detyrohen ti mbështesin materialisht.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2985-5/17 të datës 23.11.2017 e përmirësuar me dt. 27.11.2017, me të cilën ka akuzuar, E S dhe F M që të dy nga T, Republika e Shqipërisë, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se kanë kryer veprat penale, kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 parag. 1, të KP-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar të datës 05.12.2017, ka deklaruar se i propozon gjykatës që përveq tjerash të akuzuarit E S ti kthehen sendet e sekuestruara dhe ate: një brisk i vogël, dhe një unazë e femrave me guri, ngase nuk janë objekt i veprës penale dhe nuk janë bazë për konfiskim.

Të akuzuarit E S dhe F M, në shqyrtimin fillestar të datës 05.12.2017, kanë deklaruar se e pranojnë fajësinë për veprën penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare, nga neni 146 parag. 1, të KP-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit E S, av. L S, ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të saj, meqenëse paraprakisht janë konsultuar me mbrojturin e saj dhe i njëjti me vullnet të lirë dhe pa kurrfarë presioni ka pranuar fajin për veprën penale për të cilën akuzohet pasi që të të njëjtit janë sqaruar natyra dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Mbrojtësi i të akuzuarit F. M. av.O. R., ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë me faktin se i njëjti është sqaruar lidhur me favoret dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe këtë e ka bërë në mënyrë vullnetare dhe shihet edhe nga provat të cilat egzistojnë në shkresat e lëndës.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari E. S. me datë 10.11.2017, rreth orës 20:40 minuta, në pikën kufitare në fshatin V., Komuna e Prizrenit, jashtë vend kalimit kufitar rreth bregut të liqenit të V., i akuzuari ka kaluar vijën kufitare të cilën patrulla e Stacionit Policor për mbikëqyrjen e kufirit në V., ka hasur në të akuzuarin duke lëvizur në këmbë, nga pjesa e liqenit i cili nuk kishte ujë, në drejtim të rrugës për në fshatin V., ku i akuzuari kishte kaluar vijën kufitare Sh. - K., pa u lajmëruar në asnjërën pikë të kalimit kufitar, ku pas kontrollit i akuzuari nuk posedon kurrfarë dokumenti identifikues, ndërsa identifikimi i tij është bërë përmes Zyrës ndërlidhëse SPK në V.

Gjithashtu në tërësi u vërtetua se i akuzuari F. M. me datë, kohë të njëjtë si në pikën nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i akuzuari kishte kaluar vijën kufitare Sh. - K., pa u lajmëruar në asnjërën pikë të kalimit kufitar, ku pas kontrollit i akuzuari nuk posedon kurrfarë dokumenti identifikues, ndërsa identifikimi i tij është bërë përmes Zyrës ndërlidhëse SPK në Vermicë.

Gjykata gjendjen e tillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit E. S. dhe F. M. të cilët në shqyrtimin fillestar pas konsultimit me mbrojtësit e tyre vullnetarisht kanë pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohen andaj dhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka gjetur se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se të akuzuarit prej fillimit të hetimeve e gjerë në këtë shqyrtim kanë qenë të njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës dhe të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmbanë asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Në shqyrtimin fillestar, me respektimin paraprak të të gjitha të drejtave ndaj të akuzuarve, të akuzuarit vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor, i cili pranim ka të bëjë me tërë përshkrimin e ngjarjes si në dispozitiv, nga i cili rrjedhin elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë.

Sa i përket dënimit, gjykata të akuzuarit i gjykoj me dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke qenë e bindur se me një dënim të tillë tek të akuzuarit dhe në rrethin ku jetojnë, do të arrihet efekti i sanksionit penal që në të ardhmen të përmbahen nga veprimet e tilla inkriminuese dhe se një dënim i tillë i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale për të akuzuarit.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos e gjetur rrethana rënduese, si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi


vullnetar i fajësisë nga ana e të akuzuarve, janë penduar për veprën e kryer, si dhe kanë premtuar që në të ardhmen do të jenë më të kujdesshëm për tu përmbajtur nga veprime të tilla.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 453 par. 4 të KPP-së.

Me sa u tha u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
-Departamenti i Përgjithshëm-
P.nr.2182/17, më datë 05.12.2017

Bashkëpunëtori profesional,
Shahadin Destani

Gjyqtarja,
Sadije Selmani


UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit, nëpërmjet kësaj Gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në Prishtinë.